

20080170212

L I G J
PËR GARANCINË E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SIPAS MARRËVESHJES PËR
HUA, TË DEDIKUAR PËR REFORMA NË HEKURUDHË, E CILA DO TË LIDHET
NDËRMJET NP HM INFRASTRUKTURA - SHKUP DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Neni 1

Republika e Maqedonisë e garanton përmbushjen e obligimeve dhe zbatimin e dispozitave nga Marrëveshja për hua dedikuar Projektit për reforma në hekurudhë e cila do të lidhet ndërmjet NP Hekurudhat e Maqedonisë Infrastruktura - Shkup dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim në shumë prej 5 970 000 euro, në afate dhe kushte të parapara në Marrëveshjen për hua, nëse NP Hekurudhat e Maqedonisë Infrastruktura - Shkup nuk i plotëson dhe servison obligimet nga Marrëveshja për hua.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, do të përcaktohen me Marrëveshjen për hua ndërmjet NP Hekurudhat e Maqedonisë Infrastruktura - Shkup dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

Neni 3

Të gjitha obligimet të cilat dalin nga Marrëveshja për hua nga neni 1 i këtij ligji, si dhe servisimin e huas do ta kryejë NP Hekurudhat e Maqedonisë Infrastruktura - Shkup nga të hyrat të cilat i realizon, në afate dhe kushte të përcaktuara në Marrëveshjen për hua.

Neni 4

Afati i pagesës së huas nga neni 1 i këtij ligji është 17 vjet, me grejs periudhë përfshirjeje prej 5 vjetësh. Shkalla e kamatës sipas së cilës do të servisohet huaja është LIBOR (për euro valutë) plus periudha variabile. Shkalla e kamatës mund të zvogëlohet në bazë të marrjes së vendimit paraprak të Bankës ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

Huaja do të paguhet në 24 anuitete gjysëmvetore secila në shumë prej 248 750 euro. Pagesa do të bëhet në çdo 15 prill dhe 15 tetor, duke filluar nga 15 prilli 2011 deri në 15 tetor 2022.

Në grejs periudhën prej 5 vjetësh, e cila paraqet edhe periudhën e realizimit të projektit, do të paguhet vetëm kamata e huas.

Në ditën e tërheqjes së mjeteve, Republika e Maqedonisë do të paguajë provizion të njëfishtë në shumë prej 1% nga shuma e huas së Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim. Shuma e provizionit të njëfishtë mund të jetë më e vogël se 1% në bazë të marrjes së vendimit paraprak të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

Për shumën e mjeteve të patërhequra paguhet provizion në lartësi prej 0.75% në vit. Shuma e këtij provizioni mund të jetë më e vogël se 0,75% në bazë të marrjes së vendimit paraprak të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

Provizioni i mjeteve të patërhequra nga paragrafi 5 i këtij neni paguhet në gjysmëvjetor dhe atë në çdo 15 prill dhe 15 tetor çdo vit.

Neni 5

Nëse obligimet e arritura në bazë të kamatës dhe kryegjësë, në afatet e përcaktuara në Marrëveshjen për hua, në emër të NP Hekurudhat e Maqedonisë Infrastruktura - Shkup i mbulon Republika e Maqedonisë, NP Hekurudhat e Maqedonisë Infrastruktura - Shkup është e detyruar që në afat prej 30 ditësh nga dita e realizimit të obligimit, të bartë në interes të llogarisë së të

hyrave të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, mjete në denarë në lartësi të pagesës së kryer, të zmadhuar për kamatën e përllogaritur dhe të harxhimeve të bëra të lidhura me transaksionin adekuat.

Ministri i Financave ka të drejtë t'i japë urdhëresë Drejtorisë për të Hyra Publike për bllokimin e mjeteve të NP Hekurudhat e Maqedonisë Infrastruktura - Shkup në bazë të kthimit të TVSH me qëllim të përmbushjes së obligimeve të arritura ndaj kreditorit, gjegjësisht kompensim shtetit mjete në denarë në lartësi të pagesës së ekzekutive, të zmadhuar për kamatën e përllogaritur dhe për harxhimet e bëra të lidhura me transaksionin adekuat.

Neni 6

Për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella, të cilat dalin nga Marrëveshja për hua dhe Marrëveshja për garanci, Ministria e Financave dhe NP Hekurudhat e Maqedonisë Infrastruktura - Shkup obligohen të lidhin marrëveshje të veçantë.

Neni 7

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për garanci i Republikës së Maqedonisë sipas Marrëveshjes për hua, të dedikuar për projektin për reforma në hekurudhë, i cili do të lidhet ndërmjet NP Hekurudhat e Maqedonisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 109/2005).

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".